



## RAPORT I VITIT 2021 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E DREJTËSISË

### 1. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2021, Ministria e Drejtësisë (MD) kishte planifikuar konsultimin e 4 (katër) projektakteve, 3(tre) projektligje dhe 1(një) projektvendim të Këshillit të Ministrave.

Gjatë vitit 2021, MD ka realizuar 100% planin e saj të konsultimit. Numri i përgjithshëm i projektakteve për të cilët ishte planifikuar konsultim gjatë vitit 2021 ishte 4 (katër) dhe ka realizuar procesin e konsultimit publik për të katërta këto projektakte. Nga këto janë 3(tre) projektligje dhe 1(një) projektvendim.

Dy projektligje të konsultuara gjatë vitit 2021, janë të parashikuar në Planin Vjetor të Konsultimit Publik 2021 për Ministrinë e Drejtësisë. Ndërsa një projektligj dhe një projektvendim të cilët iu nënshtruan procesit të konsultimit publik gjatë vitit 2021 nuk ishin të përfshirë në Planin Vjetor të Konsultimit Publik 2021.

Nga 4 (katër) projektaktet e konsultuara gjatë vitit 2021, të gjitha janë miratuar.

#### Projektakte të konsultuara gjatë vitit 2021




Fig.1: Projektakte të konsultuara gjatë vitit 2021

Nga monitorimi i platformës së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) vihet re se për këto projektakte ka patur një numër vizitorësh në rritje nga publiku dhe për njërin prej tyre janë përcjellë rekomandime apo komente përmes RENJK, duke patur një numër prej 7271 vizitorësh në total për të katërt projektaktet për të cilat është zhvilluar konsultimi publik.

Procesi i Konsultimit Publik krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar, format e përzgjedhura të konsultimit kanë rezultuar efektive duke mundësuar mbledhjen dhe reflektimin e reagimeve të palëve të interesit në draftin përfundimtar më qëllim krijimin e projektakteve të gjithëpranuar dhe që reflektojnë interesin e publikut.

Rritja e pjesmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimarrjes nëpërmjet procesit të konsultimit publik mbetet sfida për t'u adresuar edhe më mirë nga institucioni ynë në të ardhmen.

## 2. Analiza e konsultimeve të kryera gjatë vitit 2021

### 2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

#### 2.1.1 Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Numri i përgjithshëm i akteve të miratuara nga Ministria e Drejtësisë për vitin 2021 është 22 akte.

Numri i përgjithshëm i projekt-akteve të planifikuara për konsultim për vitin 2021 nga MD ishte 4 (katër), përkatësisht 3 (tre) projektligje dhe 1 (një) projektvendim. Konkreteisht këto janë:

- Projektligji “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”;
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.110/2018 “Për noterinë”;
- Projektligji “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimit.”



Fig.2: Projektaktet e konsultuara gjatë vitit 2021, sipas planifikimit në PPAP 2021

#### 2.1.2 Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Të 4 (katër) këto projektakte i janë nënshtruar konsultimit publik. Pra, nga aktet e planifikuara për t'u konsultuar gjatë kësaj periudhe raportimi, janë konsultuar 100% e tyre.

#### 2.1.3 Sa ligje me raport VNR-je janë konsultuar?

Të 3 (tre) projektligjet që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik gjatë vitit 2021 kanë qenë të shoqëruara dhe me raportin e vlerësimit të ndikimit.

#### 2.1.4 Për sa akte në a) Program Analitik, PKIE, Dokumenta strategjik janë përdorur kriteret përjashtuese nga konsultimet publike? Cilat janë arsyt kryesore për të mos u konsultuar (nëse do të kishte të tilla)

Në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projekt dokumentet strategjike kombëtare dhe vendore, dhe për pasojë nga ana jonë konsultimi publik është parashikuar të realizohet vetëm për projektaktet që kanë detyrimin për t'u nënshtruar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1 të ligjit të lartpërmendur. Ndërsa në nenin 4 të ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik” është parashikuar lista e

projektakteve që nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, siç janë çështjet e sigurisë kombëtare që përbëjnë sekret shtetëror, marrëveshjet ndërkombëtare, aktet normative të KM me fuqinë e ligjit, emergjenca civile dhe çështje të tjera të parashikuara me ligj. Janë planifikuar për konsultim publik vetëm projektligjet dhe projektdokumentat strategjikë duke përjashtuar projektvendimet në përputhje kjo me parashikimet e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik. Referuar PPAP 2021, në total kanë qenë të parashikuara për tu miratuar 14 projektvendime, të cilat nuk in nënshtrojan procesit të konsultimit publik në përputhje me argumentat e sipërpërmendura. Nga PKIE dhe dokumentet strategjikë nuk ka akte për të cilat janë aplikuar kritere përjashtuese.

**2.1.4** Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, rregullore ministrore, etj.)?

Gjatë vitit 2021 i janë nënshtrouar konsultimit 3 (tre) projektligje dhe 1 (një) projektvendim.



Fig.3: Projektakte të konsultuara gjatë vitit 2021, sipas përfshirjes në PPAP

## 2.2. Metodat e konsultimit

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ishin 3 (tre):

1. konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik,
2. tryeza të konsultimit me ekspertë/takime online,
3. nëpërmjet faqes zyrtare të Ministrisë duke kontaktuar me adresën e emailit të personave të kontaktit.

Të 3 (tre) projektligjet e planifikuara për konsultim publik iu nënshtrojan dy metodave të konsultimit, përmes RENJK dhe tryezave të konsultimit, ndërsa 1 (një) projektvendim iu nënshtroja të treja metodave të konsultimit.

**2.2.1** Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistrin elektronik, postën elektronike, faqet e internetit, takimet publike, komitetet këshilluese, etj.)

Të 4 (katër) projektaktet e planifikuara për konsultim gjatë vitit 2021, u konsultuan përmes konsultimit në faqen zyrtare të konsultimit publik:


- Projektligji “Projektligji “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”<sup>1</sup>;
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.110/2018 “Për noterinë”<sup>2</sup>;
- Projektligji “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”<sup>3</sup>

<sup>1</sup>Shih në: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/293>

<sup>2</sup>Shih në: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/345>

<sup>3</sup>Shih në <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/287>

- Projektvendim “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimit.”;<sup>4</sup>



*Fig. 4: Metodat e konsultimit publik*

Pra, 100% e akteve të planifikuara gjatë vitit 2021 u konsultuan nëpërmjet Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Gjithashtu, të 4 (katër) aktet e planifikuara për konsultim gjatë vitit 2021, u konsultuan përmes tryezave të konsultimit me ekspertë të realizuara nga grupi i punës së hartimit të akteve/takimeve online:

- Projektligji “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.110/2018 “Për noterinë”
- Projektligji “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimit

Pra, 100% e akteve të planifikuara për këtë periudhë u konsultuan nëpërmjet tryezave të konsultimit me ekspertë/takimeve online.


Vetëm një nga projektaktet e planifikuara për konsultim gjatë vitit 2021, përkatësisht projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimit” përveç dy metodave të konsultimit të përmendura më sipër, i është nënshtruar dhe një metode të tretë të konsultimit përmes publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe thirrjes për dërgim elektronik të mendimeve.

#### *2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e tryezave të konsultimit. Numri i komenteve përmes konsultimit publik nëpërmjet regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike ishin 23 (njëzet e tre) dhe përmes konsultimit me ekspertë të realizuara nga grupi i punës për hartimin e projektakteve ishte 97 (nëntëdhjetë e shtatë)<sup>5</sup> dhe asnjë koment përmes publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>4</sup> Shih në <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/357>

<sup>5</sup> Informacion nga Drejtoria e të Drejtës Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave.



*Fig. 5: Numri i komenteve sipas metodave të konsultimit*

*2.2.3A organizoi ministria gjithashtu disa konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit realizoi konsultimin paraprak për projektligjin “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”. Konsultimi paraprak u realizua në periudhën qershor-korrik 2020 me pjesëmarrje përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës<sup>6</sup>

### **2.3.Kohëzgjatja e konsultimeve**

*2.3.1Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditët e kërkuara? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes?*

#### **Projektligji “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”**

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike u realizua në përputhje me përcaktimet në nenin 15 të ligjit.

Konsultimi elektronik për projektligjin “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” u zhvillua me kohëzgjatje prej 20 ditësh pune, nga data 18.08.2020-15.09.2020.

Për këtë projektakt janë zhvilluar dhe tryeza konsultimi:

**14 Korrik 2020-** Tryezë prezantimi dhe konsultimi e zhvilluar në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës përfaqësues nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit të MD-së dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë.

**22 Shtator 2020-** Tryezë e gjerë prezantimi dhe konsultimi në Ministrinë e Drejtësisë me përfaqësues nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit të Ministrisë, nga Sektori i Përkthimit Zyrtar për Bashkëpunimin Ndërgjyqësor në Ministri, përkthyes zyrtarë e të tjerë të ftuar.

Kontributet që janë përcjellë në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës elektronike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, me anë të regjistrit elektronik në adresën <http://ëëë.konsultimipublik.gov.al>, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë, Bulevardi

<sup>6</sup> Informacion nga punonjës të Drejtoria e të Drejtës Publike.

“Zogu I-rë”, Tiranë, si dhe në tryezat e konsultimit të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë, janë mbledhur nga struktura përkatëse në Ministri.

Përgjatë këtyre tryezave të konsultimit, Ministria e Drejtësisë dhe ekspertët e fushës që janë përfshirë në procesin e draftimit të projektakteve kanë dhënë të gjitha shpjegimet dhe sqarimet e mundshme në nivel teknik për komentet apo sugjerimet e dhëna përgjatë takimit nga pjesëmarrësit. Ky projektligj u miratua në mbledhjen e datës 13.01.2021 të Këshillit të Ministrave.

### **Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.110/2018 “Për noterinë”**

Konsultimi elektronik për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.110/2018 “Për noterinë” u zhvillua me kohëzgjatje prej 20 ditësh pune, nga data 02.04.2021-30.04.2021.

Për këtë projektakt janë zhvilluar dhe tryeza konsultimi:

**14 Maj 2021-** Tryezë konsultimi në Ministrinë e Drejtësisë me përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit dhe Kodifikimit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, e të tjerë.

**17 Maj 2021-**Tryezë konsultimi e zhvilluar online me përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit dhe Kodifikimit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, ekspertë vendas dhe ndërkombëtare të EURALIUS, si dhe përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Mars – Maj 2021 – Takime të zhvilluara online me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë të Horizontal Facility for the Eastern Balkans and Turkey II, Action against Economic Crime in Albania dhe të EURALIUS, si dhe përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Hartimi projektligjit ka kaluar përmes një dialogu të vazhdueshëm me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë për gjetjen e masave dhe formulimin e parashikimeve të duhura ligjore. Projektligji është hartuar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë të ftuar përmes komunikimeve elektronike të Horizontal Facility for the Eastern Balkans and Turkey II, Action against Economic Crime in Albania dhe të EURALIUS. Kontributi i tyre është dërguar përmes shkëmbimit të komenteve nëpërmjet postës elektronike, si dhe përmes takimeve të zhvilluara online për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. Procesi i hartimit të këtij projektligji ka kaluar përmes disa ndryshimeve me qëllim reflektimin e komenteve të aktorëve të përfshirë, si dhe përputhshmërinë e tij me Kushtetutën dhe parashikimet e tjera ligjore. Në përfundim të këtij procesi projektligji i është nënshtruar konsultimit publik përmes publikimit të tij në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike dhe dërgimit për mendim disa institucioneve.

Projektakti është konsultuar me të gjitha grupet e interesit duke përfshirë Dhomën Kombëtare të Noterisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Këshilin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe Shërbimin Informativ të Shtetit, ku këto të fundit kanë shprehur dakordësinë e tyre. Ky projektligj u miratua në mbledhjen e datës 03.11.2021 të Këshillit të Ministrave.

### **Projektligji “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme**

Në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” projektligji “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme” është publikuar në portalin e Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për periudhën 14.07.2020-

12.08.2020. Gjatë kësaj periudhe projektakti ka patur 1298 vizitorë dhe nuk është përcjellë asnjë koment përmes platformës së regjistrimit elektronik.

Projektligji “Për profesionin e ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme” u miratua me vendimin nr. 865, datë 11.11.2020 të Këshillit të Ministrave dhe u depozitua në Kuvend në datë 17.11.2020. Për shkak të mbarimit të punimeve të legjislaturës së Kuvendit, në mbështetje të nenit 87/1 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka kthyer këtë nismë pranë Këshillit të Ministrave, si institucioni propozues, si dhe Ministrisë së Drejtësisë si institucioni përgjegjës për nismën.

Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e institucionit propozues të kësaj nisme, ka rishqyrtuar nismën dhe ripunuar projektligjin, varianti i ripunuar i të cilit është konsultuar edhe me grupet e interesit. Për këtë qëllim, drafti i ripunuar i projektligjit i është dërguar përfaqësuesve të sektorit të ndërmjetësimit për pasuritë e paluajtshme në vend, të cilët kanë përcjellë komentet dhe sugjerimet e tyre. Gjithashtu, në datë 11.11.2021 u zhvillua takim konsultues me përfaqësues të grupeve të interesit, ku u diskutua mbi komentet dhe sugjerimet e percjella. Ky projektligj u miratua në mbledhjen e datës 15.12.2021 të Këshillit të Ministrave.

### **Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimit**

Konsultimi elektronik për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimit u zhvillua me kohëzgjatje prej 20 ditësh pune, nga data 11.06.2021-08.07.2021.

Për këtë projektakt janë zhvilluar dhe tryeza konsultimi:

#### ***Takimet on-line/Palët e Interesuara***

1. 22 Qershor 2021, ora 10:00-11:00, Përfaqësues të Profesioneve të lira; Përmbarues, Ndërmjetës, Noterë;
2. 23 Qershor 2021, ora 10:00-11:00, Kryetarët e Gjykatave/Drejtuesit e Prokurorive të të gjitha shkallëve;
3. 23 Qershor 2021, ora 14:00-15:00, Përfaqësues të univerisiteteve/fakulteteve publike dhe private;
4. 24 Qershor 2021, ora 13:30: 16:00, GNPIE;
5. 24 Qershor 2021, ora 17:00-18:00, Shkolla e Magjistraturës;
6. 28 Qershor 2021, ora 10:00-11:00, Kryeministria;
7. 28 Qershor 2021, ora 13:00-14:00, Sektori i Biznesit;
8. 29 Qershor 2021, ora 13:00-14:00, Shoqëria Civile;
9. 30 Qershor 2021, ora 12:00-13:00, Partnerët Ndërkombëtarë/Donatorët;
10. 1 Korrik 2021, ora 11:00-12:00, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, 0 pjesëmarrës
11. Takimi përmbyllës: Konferenca “5 vjet nga Reforma në Drejtësi, Konsolidimi i sistemit të Drejtësisë nëpërmjet Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025”, 23 korrik 2021, Hotel Rogner, Tiranë

Kontributet që janë përcjellë në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektaktit, nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës elektronike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë, Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë, si dhe në tryezat e konsultimit të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë/takimet online, janë mbledhur nga struktura përkatëse në Ministri.

Përgjatë këtyre tryezave të konsultimit, Ministria e Drejtësisë dhe ekspertët e fushës që janë përfshirë në procesin e draftimit të projektaktit kanë dhënë të gjitha shpjegimet dhe sqarimet e mundshme në nivel teknik për komentet apo sugjerimet e dhëna përgjatë takimit nga

pjesëmarrësit. Ky projektvendim u miratua në mbledhjen e datës 24.12.2021 të Këshillit të Ministrave.

### 2.3.2 Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për këtë periudhë ishte 7 (shtatë) muaj. Kjo përlogaritje është bërë duke patur në vëmendje kohën (numrin e muajve) gjatë të cilës ka filluar puna për identifikimin e grupeve të interesit, zhvillimin e konsultimeve paraprake, hartimin e draftit, publikimin e tij në RENJK, marrjen dhe vlerësimin e komenteve dhe përgatitjen e një drafti final për secilin projektakt.

### 2.3.3A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin e kaluar situata ka pasur përmirësime të dukshme të procesit të konsultimit, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik rezultoi të jetë në rritje.

Gjatë vitit 2021 Ministria e Drejtësisë rezultoi me një shkallë realizimi të procesit të konsultimit publik 100%, por jemi të mendimit se situata lidhur me këtë proces është përmirësuar në krahasim me vitin apo edhe vitet paraardhëse.

Të dhënat e përftuara nga Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike tregojnë se është rritur numri i komenteve të përcjella përmes kësaj platforme, pavarësisht se numri i vizitorëve ka qenë më i ulët përkatësisht 7271 në total për vitin 2021 ndërsa në vitin 2020 numri i vizitorëve ka qenë 8055 në total. Gjatë vitit 2021 vihet re një interes në rritje i komenteve të përcjella përmes platformës së regjistrimit elektronik.




Fig.6: Krahasim i numrit të vizitorëve të RENJK në 2020 dhe 2021

## 2.4. Palët e interesit të përfshira

### 2.4.1 Sa palë interesi të jashtme morën pjesë në grupet e punës për hartimin e akteve gjatë vitit? Sa eksperte ishin në tryeza?

Gjatë vitit 2021 aktorët pjesëmarrës ishin kryesisht ekspertë të fushës, përfaqësues të institucioneve shtetërore, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, partnerë ndërkombëtare, gjykatat, prokuroritë, përkthyesit zyrtarë, Këshilin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorinë e Përgjithshme, Dhoma Kombëtare e Noterisë si dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë. Numri total i pjesëmarrësve që kanë kontribuar për hartimin e 4 (katër) projektakteve të konsultuara gjatë vitit 2021 ka qenë 14 (katërmëdhjetë).



Konkretisht, në projektligjin “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” procesi i hartimit u shoqërua nga një komunikim shumë intensiv bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të përfshira, dhe 2 (dy) ka qenë numri i ekspertëve pjesëmarrës në grupin e punës.

Në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.110/2018 “Për noterinë” procesi i hartimit të tij ka kaluar përmes një dialogu të vazhdueshëm me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë për gjetjen e masave dhe formulimin e parashikimeve të duhura ligjore. Projektakti është konsultuar me të gjitha grupet e interesit duke përfshirë Dhomën Kombëtare të Noterisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Këshilin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe Shërbimin Informativ të Shtetit dhe 3 (tre) ka qenë numri i ekspertëve pjesëmarrës në grupin e punës.

Projektligji “Për ndërmetësit e pasurive të paluajtshme” janë përfshirë 4 (katër ekspertë). Përgjatë tryezave të konsultimit të zhvilluara, nga ana e Ministrisë janë dhënë të gjitha shpjegimet dhe sqarimet e mundshme në nivel teknik për çdo koment apo sugjerim të shfaqur nga ana e operatorëve në tregun e ndërmjetësimit të pasurive të paluajshme, duke u parashtruar dhe shpjeguar qasjen që është ndjekur nga Ministria e Drejtësisë dhe alternativat e mundshme që janë marrë në konsideratë gjatë draftimit të këtij projektligji, si dhe avantazhet dhe disavantazhet në rast implementimi të tyre në të ardhmen, duke ruajtur fokusin në synimet kryesore që drafti në fjalë kërkon të përmbushë.

Në projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimit” procesi i hartimit u shoqërua nga një komunikim shumë intensiv bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të përfshira dhe grupeve të interesit, dhe 5 (pesë) ka qenë numri i ekspertëve pjesëmarrës në grupin e punës.



Fig.7: Pjesëmarrja e ekspertëve në grupet e punës

#### 2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individual, OSHC, kompani, etj.)

Për konsultimin e projektligjeve gjatë vitit 2021, pjesëmarrësit në tryezat e konsultimit ishin:

- ekspertë individual,
- përfaqësues nga organizatat jofitimprurëse, nga përkthyesit zyrtarë
- përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, dhe
- përfaqësues nga institucione publike të pavarura apo institucione të varësisë.

### 2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të bëra për projektakte në vitin e caktuar?

Gjatë procesit të konsultimit, kryesisht të gjithë pjesëmarrësit në tryezat e konsultimit kanë qenë aktivë duke dhënë sugjerime dhe komente, në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe përmbajtjes së projektakteve. Numri total i pjesëmarrësve që kanë kontribuar për hartimin e 4 (katër) projektakteve të konsultuara gjatë vitit 2021 ka qenë 14 (katërbëdhjetë).

Gjithashtu në të shumtën e rasteve komentet dhe rekomandimet e tyre janë përcjellë edhe me shkrim (në rrugë zyrtare apo nëpërmjet komunikimit elektronik), pas zhvillimit të tryezave përkatëse.




Fig.8: Numri i komenteve në tryezat e konsultimit për secilin projektakt

### 2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Pjesa më e madhe e komenteve janë përcjellë kryesisht nga përfaqësues të institucioneve shtetërore, por dhe nga partnerët ndërkombëtare, nga organizatat jofitimprurëse etj.

### 2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga Ministria e Drejtësisë. Gjithashtu, edhe një tjetër tregues rezulton dhe nga monitorimi i portalit të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike pasi vërehet një rritje e numrit të qytetarëve që ndjekin projektaktet e publikuara në të dhe dërgimi i komenteve përmes kësaj platforme. Numri total i vizitorëve për projektaktet gjatë vitit 2021 ka qenë 7271. Këto të dhëna janë trajtuar dhe grafikisht përkatësisht në figurën nr.6

## 2.5.Rekomandimet dhe komentet e marra

Gjatë vitit 2021 kontributet e mbledhura në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektakteve, janë përcjellë nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës elektronike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, me anë të regjistrimit elektronik në adresën <http://ëëë.konsultimipublik.gov.al>, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë, si dhe nëpërmjet komenteve të drejtpërdrejta në tryezat e konsultimit të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë.

*2.5.1Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Numri i komenteve përmes konsultimit publik nëpërmjet regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike ishin 23 (njëzet e tre) dhe përmes konsultimit me ekspertë të realizuara nga grupi i punës për hartimin e projektakteve ishte 97 (nëntëdhjetë e shtatë)<sup>7</sup> dhe asnjë koment përmes publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. Referohu fig.5 lart.

*2.5.2Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Për të 4 (katër) projektaktet e konsultuara gjatë vitit 2021 numri total i komenteve të përcjella ka qenë 120 (njëqind e njëzet), prej të cilave:

- 57 janë pranuar plotësisht
- 30 janë refuzuar plotësisht
- 33 janë pranuar pjesërisht .



*Fig. 9: Numri i komenteve të pranuar dhe refuzuara*

Pra, 48% e komenteve përcjella gjatë procesit të konsultimit publik të projektakteve janë pranuar, 28% e tyre janë pranuar pjesërisht dhe 24% janë refuzuar.

<sup>7</sup>Informacion nga Drejtoria e së Drejtës Publike dhe Drejtoria e Politikave.

### *2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga Ministria e Drejtësisë. Gjithashtu, edhe nga monitorimi i portalit të Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet Publike vërehet një rritje e numrit të komenteve të përcjella nga qytetarët përmes kësaj platforme.

### *2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Gjatë vitit 2021 janë konsultuar vetëm 3 (tre) akte të cilat shoqërohen me VNR.

### *2.5.5 Ndarja e praktikave më të mira nga procesi i konsultimit publik për periudhën e fundit*

Nga praktikat më të mira për procesin e konsultimit publik mund të përmendim projektligjin “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, për të cilin rezultoi të kemi konsultime paraprake, tryeza konsultimi si dhe publikimin e projektaktit në portalin e RENJK. Përdorimi i disa mënyrave të konsultimit ka shtuar mundësinë e hartimit të një politike më efikase në këtë rast. E vlerësojmë si një nga praktikat më të mira sepse është i vetmi projektakt për të cilin janë përcjellë për herë të parë komente përmes regjistrisë elektronike për njoftimet dhe konsultimet publike.

## **2.6. Rezultatet e raporteve të konsultimeve**

### *2.6.1 Sa raporte konsultimesh publikoi ministria?*

Ministria e Drejtësisë ka hartuar dhe publikuar publikuar në portalin e regjistrisë elektronike për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK) raportin e konsultimit për të treja projektaktet konkretisht:

- Raport konsultimi për projektligjin “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”
- Raport konsultimi për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.110/2018 “Për noterinë”
- Raport konsultimi për projektligjin “Për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme”
- Raport konsultimi për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimit

### *2.6.2 Nëse disa nuk u botuan, cilat janë arsyet?*

Për vitin 2021 Ministria e Drejtësisë ka hartuar raporte konsultimi për të gjitha projektaktet për të cilat ishte planifikuar procesi i konsultimit publik, 4 (katër) të tilla dhe janë publikuar në portalin e regjistrisë elektronike për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK) të gjitha raportet.

## **2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeks të cilësisë së performancës institucionale në përpunim të kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve**

Projektligji “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”: 8

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.110/2018 “Për noterinë”: 8

Projektligji “Për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme”: 8

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimit: 8

Institucioni vlerëson se konsultimi i këtyre projektakteve ka qenë në nivel shumë të mirë. Për këto projektakte janë përdorur tre metoda të konsultimit publik përkatësisht, publikimi në faqen zyrtare të konsultimit publik, tryeza të konsultimit mr ekspertë/takome online dhe nëpërmjet faqes zyrtare të Ministrisë duke kontaktuar me adresën e emailit të personave të kontaktit.

### *3. Sfidat, rreziqet kryesore dhe mundësitë për të ardhmen*

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithëpërshirjen e publikut në këtë proces. Ende nuk reflektohet qartësisht një kulturë e angazhimit në proceset e hartimit të politikave. Megjithë përpjekjet dhe mundësitë e ofruara nga Ministria e Drejtësisë, ende nuk ka përfshirje aktive të publikut në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen. Për periudhën e ardhshme, me qëllim përmirësimin e procesit, organizimi i konsultimeve është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik. Mendojmë se për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të siguruar një përfshirje sa më të madhe të publikut në këtë proces, është e nevojshme dhe zhvillimi i trajnimeve mbi procesin e konsultimit publik për të gjithë punonjësit që merren me hartim legjislativ. Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik.